



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Datë: 09/02/23 Ref.: 139/23

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-031 (GZ, Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (tutje KShC), në vazhdimin e mbledhjes së 108-të, të mbajtur me datë 16.01.2023, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit AAB kampusi kryesor, me Nr.Prot.1867/22 e datës 31.10.2022 akreditimin/riakreditimin e programeve të studimeve:
1. Menaxhment, BA, 180 ECTS, (A);
 2. Fizioterapi, Bachelor Professional, 180 ECTS, (A);
 3. Teknik i Labororit, BSc 180 ECTS, (A);
 4. Përkujdesje dhe mirëqenie e fëmijëve MA, 60 ECTS (A);
 5. Gjuha Gjermane - përkthim dhe interpretim, Bachelor Professional, 180 ECTS (A);
 6. Dizajn i brendshëm, Bachelor Professional, 180 ECTS (A).
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji AAB kampusi kryesor, ka parashtruar kërkesë me Nr.Prot.1867/22 e datës 31.10.2022 pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (tutje AKA), për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimeve:

1. Menaxhment, BA, 180 ECTS, (A);
2. Fizioterapi, Bachelor Professional, 180 ECTS, (A);
3. Teknik i Labororit, BSc 180 ECTS, (A);
4. Përkujdesje dhe mirëqenie e fëmijëve MA, 60 ECTS (A);
5. Gjuha Gjermane - përkthim dhe interpretim, Bachelor Professional, 180 ECTS (A);
6. Dizajn i brendshëm, Bachelor Professional, 180 ECTS (A).

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim). Në paragrafin 1.2 të nenit 10 të UA, thuhet, "Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuar në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti

përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-se".

Të dhënat janë prezantuar në mbledhjen e KShC-së të mbajtur me 19 dhjetor 2022, dhe pas shqyrtimit të detajuar të aplikacionit/kërkesës, verifikimit të dokumentacionit relevant të kualifikimit për secilin staf akademik të programit të studimit, KShC mori vendim që të refuzoj aplikacionin.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: "Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit".

1. Për programin e studimit: *Menaxhment, BA, 180 ECTS, (A)*; Kolegji AAB, si bartës të këtij programi, ka paraparë: Gëzim Jusufi PhD në Ekonomi, Pranvera Dalloshi PhD në Ekonomi, Shkumbin Misini PhD në Ekonomi, Naim Ismajli "Doktor në shkollë ekonomike, me profil në Menaxhim", Blerta Haliti Baruti PhD në Ekonomi, Fidan Qerimi Ekonomia dhe Menaxhimi.

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit duhet të ketë të paktën tre (3) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit për stafin akademik, KShC ka konstatuar se bartësit; Gëzim Jusufi PhD në Ekonomi ka pagë primare diku tjetër. Pranvera Dalloshi PhD në Ekonomi i mungon diploma. Shkumbin Misini PhD në Ekonomi, titulli akademik nuk përkon me fushën e programit të studimit. Blerta Haliti Baruti PhD në Ekonomi, titulli akademik nuk përkon fushën e programit të studimit dhe për këtë nuk mund të jenë bartës të këtij programi.

Sipas paragrafit 5, nënparagrafi 5.1 dhe 5.2 të Manualit të akreditimi kërkohet që bartësit e programeve që hyjnë në proces të akreditimit, riakreditimit ose validimit në nivelin BA/BSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike Prof. Ass. dhe të paktën 1 (një) publikim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit/programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike Prof. Ass. dhe 2 (dy) punime në revista shkencore të indeksuara nga fusha e studimit/programit, si autor i parë apo korrespondent, sipas nenit 3, pika 1.1. WEB OF SCIENCES koleksioni bërthame (SCIE, SSCI dhe AHCI) apo 1.2 SCOPUS, duke përjashtuar revistat ose shtëpitë botuese të dyshimta sipas UA 01/2018 të aprovuar nga MASHTI.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara, verifikimin e të dhënave dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë (Nenin 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.14 dhe pikës 1.2.4 të nenit 10 të UA për Akreditim dhe Manualit të akreditimi (përditësuar me vendimin Ref.932/22)), KShC vendosi që në munges të stafit akademik të refuzoj aplikacionin për programin e studimit; *Menaxhment, BA, 180 ECTS, (A)*;

2. Për programin e studimit: *Fizioterapi, Bachelor Professional, 180 ECTS, (A)*, Kolegji AAB, si bartës të këtij programi, ka paraparë: Zenel Kozhani Master në Fizioterapi, Bardha Agushi Master në Fizioterapi dhe Gazmend Kozhani Master në Fizioterapi.

Programi është propozuar me 180 ECTS, sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit IAL duhet të ketë të paktën tre (3) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit dhe të stafit akademik, KShC ka konstatuar se si arsye kryesore e refuzimit të këtij programi është fakti se konform nenit 1 të Ligjit për Arsimin e Lartë, "Arsimi i lartë në

Kosovë është në përputhje me standardet evropiane". Standardet evropiane në fushën e fizioterapisë zbatohen direktivat e Fizioterapisë Botërore, për regionin e Evropës. Në udhëzuesin e kësaj organizate "Physical therapist professional entry level education", thuhet se programet e fizioterapisë aplikohen në nivel universitar jo më pak se 4 vite, ose 240 kredi. AKA posedon dëshmi me shkrim edhe nga organizata e Fizioterapisë Botërore dhe nga Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës, si anëtare e kësaj organizate me të drejta të plota. Në asnjë nga direktivat e BE-së apo vendet zbatuese të EHEA, nuk ka raste kur programet mjekësore ofrohen si programe profesionale, por vetëm si programe shkencore.

Poashtu arsye tjetër shtesë është se KShC ka vërtetuar se asnjëri nga bartësit e propozuar për programin; *Fizioterapi, Bachelor Professional, 180 ECTS, (A)*, nuk ka vendim për titullin akademike (thirrje) dhe nuk ka asnjë punim të publikuar, ashtu siç kërkohet sipas paragrafit 5, nënparagafi 5.2 të Manualit të akreditimi kërkohet që bartësit e programeve që hyjnë në proces të akreditimit, riakreditimit ose validimit në nivelin BA/BSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike Prof. Ass. dhe të paktën 1 (një) publikim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit/programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike Prof. Ass. dhe 2 (dy) punime në revista shkencore të indeksuara nga fusha e studimit/programit, si autor i parë apo korrespondent, sipas nenit 3, pika 1.1 WEB OF SCIENCES koleksioni bërthame (SCIE, SSCI dhe AHCI) apo 1.2 SCOPUS, duke përfshirë revistat ose shtëpitë botuese të dyshimta sipas UA 01/2018 të aprovuar nga MASHTI.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara, verifikimin e të dhënave dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë (Nenin 26, pika 5.3.4 të UA për Akreditim dhe Manualit të akreditimi (përditësuar me vendimin Ref.932/22)) dhe standardeve evropiane të aplikuara në fushën e studimit, KShC vendosi që të refuzoj aplikacionin për programin e studimit; *Fizioterapi, Bachelor Professional, 180 ECTS*.

3. Për programin e studimit: *Teknik i Laboratorit, BSc 180 ECTS, (A)*; Kolegji UBT kampusi kryesor, ka paraparë si bartës; Donjeta Hajdari PhD në Biomjekësi dhe Shkenca Shëndetësore, Valdete Haxhibeqiri PhD në Mjekësi, Ajete Aliu Bejta PhD në Biomjekësi dhe Shkenca Shëndetësore dhe Ylber Bajraktari PhD në Bioteknologji Bimore.

Programi ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit IAL duhet të ketë të paktën tre (3) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit për stafin akademik, KShC ka konstatuar se bartësit; Donjeta Hajdari PhD në Biomjekësi dhe Shkenca Shëndetësore, Valdete Haxhibeqiri PhD në Mjekësi, Ajete Aliu Bejta PhD në Biomjekësi dhe Shkenca Shëndetësore sipas të dhënave të verifikuara kanë nga tri paga primare, e që bien në kundërshtim me dispozitat logjore në fuqi që rregullojnë fushën e akreditimit.

Kurse Ylber Bajraktari PhD në Bioteknologji Bimore, titulli akademik nuk përkon fushën e programit të studimit dhe për këtë nuk mund të jenë bartës të këtij programi.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara, verifikimin e të dhënave dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë (Nenin 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.14 të UA për Akreditim dhe Manualit të akreditimi (përditësuar me vendimin Ref.932/22)), KShC vendosi që në mungesë të stafit akademik adekuat të refuzoj aplikacionin për programin e studimit; *Teknik i Laboratorit, BSc 180 ECTS*.

4. Për programin e studimit: *Përkujdesje dhe mirëqenie e fëmijëve MA, 60 ECTS (A)*; Kolegji AAB, ka paraparë si bartës; Osman Buleshkaj PhD në Mësimdhënie dhe Menaxhim në Arsim dhe Arif Shala PhD in Education Sciences.

Programi ka 60 ECTS dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit IAL duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit për programin dhe stafin akademik, KShC ka konstatuar se titulli akademik aktual i asnjërit nga bartësit nuk përkon me fushën e programit të studimit dhe nuk është i mjaftueshëm për akreditimin e këtij programi sipas dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë fushën e akreditimit.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara, verifikimin e të dhënave dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë (Nenin 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.14 të UA për Akreditim dhe Manualit të akreditimi (përditësuar me vendimin Ref.932/22)), KShC në mungesë të stafit akademik adekuat, vendosi që të refuzoj aplikacionin për programin e studimit; *Përkujdesje dhe mirëqenie e fëmijëve MA, 60 ECTS (A)*;

5. Për programin e studimit: *Gjuha Gjermane - përkthim dhe interpretim, Bachelor Professional, 180 ECTS (A)*; Kolegji AAB kampusi kryesor, ka paraparë si bartës; Shkurte Veliu Ajdini "Master në Gjuhë dhe Letërsi Gjermane "Kandidat për doktoraturë", Armend Bytyqi Master në Studime Gjermane dhe Miradije Miftaraj Master në Studime Gjermane.

Programi ka BSc 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit IAL duhet të ketë të paktën tre (3) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit për stafin akademik, KShC ka konstatuar asnjëri nga bartësit nuk kanë titullin akademik (thirrjen) e kërkuar sipas Manualit për akreditim, që sipas paragrafit 5, nënparagafi 5.2 të Manualit të akreditimi kërkohej që bartësit e programeve që hyjnë në proces të akreditimit, riakreditimit ose validimit në nivelin BA/BSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike Prof. Ass. dhe të paktën 1 (një) publikim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit/programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike Prof. Ass. dhe 2 (dy) punime në revista shkencore të indeksuara nga fusha e studimit/programit, si autor i parë apo korrespondent, sipas nenit 3, pika 1.1 WEB OF SCIENCES koleksioni bërthame (SCIE, SSCI dhe AHCI) apo 1.2 SCOPUS, duke përjashtuar revistat ose shtëpitë botuese të dyshimta sipas UA 01/2018 të aprovuar nga MASHTI.

Poashtu arsye tjetër shtesë është se KShC ka konstatuar se bartësit e propozuar; Armend Bytyqi Master në Studime Gjermane dhe Miradije Miftaraj kanë nga tri paga primare, e që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë fushën e akreditimit.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara, verifikimin e të dhënave dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë (Nenin 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.14 të UA për Akreditim dhe Manualit të akreditimi (përditësuar me vendimin Ref.932/22)), KShC vendosi që të refuzoj aplikacionin për programin e studimit; *Gjuha Gjermane - përkthim dhe interpretim, Bachelor Professional, 180 ECTS (A)*.

6. Për programin e studimit: *Dizajn i brendshëm, Bachelor Professional, 180 ECTS (A)*, Kolegji AAB kampusi kryesor, ka paraparë si bartës; Bujar Selimi "Master i Dizajnit Grafik dhe Master në Dizajn të Brendshëm", Valon Xhelili MA në Arkitekturë, Hektor Vokshi "Master i Arkitekturës dhe Master Profesional i Eficiencës së Energjisë" dhe Nora Ahmeti Allan Master në Arkitekturë të Brendshme

Programi ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit IAL duhet të ketë të paktën tre (3) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit për stafin akademik, KShC ka konstatuar se asnjëri nga bartësit nuk ka PhD, nuk ka vendim për titullin akademik (thirrjen) e kërkuar sipas Manualit për akreditim, që sipas paragrafit 5, nënparagafi 5.2 të Manualit të akreditimi kërkohej që bartësit e programeve që hyjnë në proces të akreditimit, riakreditimit ose validimit në nivelin BA/BSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike Prof. Ass. dhe të paktën 1 (një) publikim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit/programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike Prof. Ass. dhe 2 (dy) punime në revista shkencore të indeksuara nga fusha e studimit/programit, si autor i parë apo korrespondent, sipas nenit 3, pika 1.1 WEB OF SCIENCES koleksioni bërthame (SCIE, SSCI dhe AHCI) apo 1.2 SCOPUS, duke përfshirë revistat ose shtëpitë botuese të dyshimta sipas UA 01/2018 të aprovuar nga MASHTI.

Poashtu arsye tjetër shtesë KShC ka konstatuar se bartësi Valon Xhelili MA në Arkitekturë nuk ka publikim siç kërkohej me Manualin e akreditimit dhe i njëjti ka dy paga primare, e që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë fushën e akreditimit. Kurse bartësit; Bujar Selimi, Valon Xhelili dhe Nora Ahmeti Allan nuk kanë publikimet siç kërkohej në paragrafin 5, nënparagafi 5.2 të Manualit të akreditimit (përditësuar me vendimin Ref.932/22), nuk janë të fushës dhe se programi Dizajn i brendshëm, Bachelor Professional, 180 ECTS (A) ka kod të gabuar Erasmus.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara, verifikimin e të dhënave dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë (Nenin 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.14 të UA për Akreditim dhe Manualit të akreditimit KShC vendosi që në mungesë të stafit akademik adekuat të refuzoj aplikacionin për programin e studimit; Dizajn i brendshëm, Bachelor Professional, 180 ECTS (A).

KSHC pas verifikimit të dokumentacionit për stafin akademik, shqyrtimit dhe analizimit të fakteve të prezantuara me sipër, duke u bazuar në paragrafin 1.3, nënparagafi 1.3.2 të nenit 10 të UA për akreditim, vendosi të refuzohet kërkesa e Kolegjit AAB kampusi kryesor për akreditimin e programeve të cekura më lartë pasi që programet e studimit përkatësisht bartësit e programeve nuk i plotësojnë kushtet preliminare për akreditim/riakreditim të përcaktuara me Ligjin për Arsimit të Lartë, Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Manualit të akreditimit, (përditësuar me vendimin Ref.932/22).

Andaj KShC në përputhje me legjislacionin në fuqi, faktet e prezantuara dhe kompetencat ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në organin kompetent në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji AAB kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.




Prof. Asoc. Dr. Hasnija Idrizi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë